

**KONTRATE PER SHITJEN E KUOTAVE TE KAPITALIT THEMELTAR TE SHOQERISE
ORANGE PLUS Shpk.**

Sot me 08.12.2020, Palet e meposhtme lidhin kete kontrate shitblerje kuotash:

Z. Gjergj Skendaj, shtetas shqiptar, lindur me 29.08.1981, ne Tirane, dhe banues ne Tirane, (“Shitesi”)

dhe

Znj. Anisa Skendaj, shtetase shqiptare, lindur me 17.12.1984, ne Tirane dhe banuese ne Tirane (“Bleresi”)

MEQENESE

- A. Orange Plus eshte nje shoqeri e organizuar dhe qe ekziston sipas ligjeve te Republikes se Shqiperise, e regjistruar me Regjistrin Tregtar me numer biznesi L91611032R dhe me seli te regjistruar ne adresen: Rr. Dervish Hima nr. 1, Tirane, Shqiperi (“Shoqeria”).
- B. Ne daten e ketij akti, Shitesi zoteron 1 pjese te kapitalit themeltar te Shoqerise qe perfaqesojne 100% te ketij kapitali (“Kuota”).
- C. Sipas termave dhe ne perputhje me kushtet e percaktuara ne kete Kontrate, Bleresi kerkon te bleje dhe perftoje dhe Shitesi kerkon te shese dhe transferoje te Bleresi Kuoten.

Per sa me siper, Palet bien dakord si me poshte:

1. Termat si me poshte do te kene kuptimet si ne vijim, pervec kur konteksti qe perdoren dikton ndryshe:

Kontrate do te thote kjo Kontrate Shitje Kuotash.

Date e Kontrates do te thote data e nenshkrimit te kesaj Kontrate.

2. Ne perputhje me termat dhe kushtet e kesaj Kontrate, Shitesi i shet Bleresit dhe Bleresi blen dhe pranon nga Shitesi, Kuoten, me garanci te plote mbi titullin dhe te lire e te paster nga çdo e drejte e pale te trete.
3. Cmimi i Kuotes eshte 100.000 Leke (njqind mije Leke), paguhet nga Bleresi me nenshkrimin e kesaj Kontrate. Shitesi pranon se ka marre te plote pagesen e cmimit te Kuotes dhe se nuk ka asnje pretendim lidhur me kete pagese.
4. Titulli i pronesise mbi Kuoten i transferohet Bleresit me nenshkrimin e kesaj Kontrate.
5. Shitesi autorizon nepermjet kesaj Kontrate regjistrimin e transferimit te pronesise se Kuotes, ne emrin dhe pronesine e Bleresit, ne Regjistrin Tregtar shqiptar prane Qendres Kombetare te Biznesit. Bleresi do te pergatise dhe depozitaje te gjitha aplikimet e nevojshme qe kerkohen per depozitimimin e kesaj Kontrate ne Regjistrin Tregtar shqiptar prane Qendres Kombetare te Biznesit.

6. Shitesi deklaron dhe pranon se eshte i njohur me gjendjen financiare dhe pasurore te Shoqerise dhe se nuk ka asnje pretendim kundrejt Shoqerise, perfaqesuesve te saj, dhe/ose Bleresit, qofte ky pretendim financiar apo i ndonje natyre tjeter, qofte ne cilesine e ortakut apo ne ndonje cilesi tjeter.
7. Per çeshtjet te cilat nuk jane parashikuar ne kete Kontrate apo qe mund te rrjedhin prej saj do te zbatohet legjislacioni perkates ne fuqi ne Republiken e Shqiperise i cili eshte ligji i zbatueshem per kete Kontrate.
8. Çdo mosmarveshje qe mund te linde midis paleve te kesaj Kontrate ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e kesaj Kontrate, nese nuk zgjidhet ne mirekuptim mes vete paleve, do te zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane, vendimet e se ciles jane te ankimeshme sipas dispozitave te Kodit te Procedures Civile te Republikes se Shqiperise.
9. Kjo Kontrate pergatitet dhe nenshkruhet ne 2 kopje origjinale dhe ky akt perben te gjithe marveshjen e arritur midis paleve, premtimet, deklarimet, garancite ne lidhje me objektin e kesaj Kontrate. Asnje ndryshim i kesaj Kontrate nuk do te jete i vlefshem nese nuk behet me shkrim dhe nenshkruhet nga secila pale ose perfaqesues te autorizuar rregullisht nga secila pale.

SHITESI

Gjergj Skendaj

Gjergj Skendaj

G

BLERESI

Anisa Skendaj

Anisa Skendaj

Anisa Skendaj

